



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË
KRYETARI I KËSHILLIT**

Nr 3384/Prot

Gjirokastër më 06 :09 :2023

Lënda: Procesverbal i mbledhjes së datës 31.08. 2023.

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së datës 31.08. 2023

PROCESVERBAL

I mbajtur sot në **datë 31.08.2023** në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastër. Mbledhja po zhvillohet në sallën e Mediatekës pranë Universitetit “ Eqrem Çabej”. Mbledhja fillon në orën 12:06

Marrin pjesë në mbledhje 17 anëtarë .

Mungojnë në mbledhje; Lindita Rova, Eri Shehaj, Dashnor Aliko, Ardita Koçollari, Sokol Feruni, Armand Hilaj, Orgesa Haska, Ledion Pandos, Enkelejda Mahmutaj, Anila Cacaj, Viron Peta, Adrian Novi, Manjola Shehaj, Dashamir Qeli.

Hapet mbledhja nga Znj Isaraj. Është kuorumi për fillimin e mbledhjes.

Znj Isaraj paraqet rendin e ditës me disa saktësime.

1. Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 31.07.2023.
2. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin **01-31.08. 2023**”.
3. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **01-31.08. 2023**”.
4. P/Vendim “Për një ndryshim në VKB Nr. 100, datë 16.12.2022 “Për miratimin e PBA 2023-2025 dhe Buxhetit Vjetor 2023” me qëllim financimin e projekteve të investimeve”.
5. P/Vendim “Për miratimin e Planit të Mbrojtjes Civile të bashkisë Gjirokastër për periudhën 2023-2027”.
6. Raport i drejtorisë së Arsimit pranë Bashkisë Gjirokastër për masat e marra për fillimin e Vitit Shkollor 2023-2024.
7. P/Vendim “Për përcaktimin e datave dhe vendeve ku mbahen zgjedhjet”.
8. P/Vendim “Për ngritjen e Komisionit për Monitorimin e Zgjedhjeve të Strukturave Komunitare në nivel bashkie ”.
9. P/Vendim “Për ngritjen e Komisionit për Monitorimin e Zgjedhjeve të Strukturave Komunitare në nivel fshati”.
10. P/Vendim “ Për ngritjen e komisioneve të qendrave të votimit”.
11. P/Vendim “ Për dhënien e titullit “ Qytetar Nderi” për z. Fabrizio Buci”.

12. Të ndryshme.

Hidhet në votë dhe miratohet rendi I ditës me 17 vota pro.

Hidhet në votë dhe miratohet procesverbali I mbledhjes me 16 vota pro dhe një abstenim.

Hidhen në votë dhe miratohen me 17 vota pro dy pikat e ndihmës ekonomike. P/Vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin **01-31.07. 2023**".

P/Vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin **01-31.07. 2023**".

Pika 4 e rendit të ditës hidhet për diskutim.

Jepen sqarime në lidhje me këtë pikë dhe me kërkesën e këshilltarëve të grupit Bashkë Fitojmë në lidhje me shpenzimet për paga ndër vite nga znj. Artiste Koko. Matëriali mund të tërhiqet nga këshilltarët pranë sekretares së këshillit.

Në lidhje me pikën 4 të rendit të ditës ju informoj se ky material është në mbështetje nga Ministria e Ekonomisë për mbështetjen e familjeve në nevojë. Këto familje I përkasin komunitetit rom dhe egjiptian dhe trajtohen me ndihmë ekonomike nga bashkia. Projekti është fituar nga bashkia Gjirokastër dhe 4milion leke jepen nga bashkia dhe 16 milion nga M.E.

Kurse pjesa tjetër ka të bëjë e marrëveshjen me Ambasadën Japoneze ku fondet e papërdorura I kthehen ambasadës.

Z. Brahimi: Dokumenti është I qartë dhe I plotë, por nuk shoh në listë familjen nga Kolonja që I është djegur shtëpia. E di që është ndihmuar nga bashkia.

Znj. Jorida Muho: Bashkia ka bërë 4 thirrje publike për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike. Kjo punë ka filluar dhe është në vazhdimësi në zbatim të përkrahjes sociale për familjet në nevojë. Përsa I përket fatkeqësive natyrore I takon emergjencave dhe jane dy grande të ndryshme. Kusht që familjet të përfitojnë nga këto ndërhyrje është që familja të ketë certifikatën e pronësisë së banesës.

Z. Spartak Drasa: Komisioni që përzgjedh banesat është nga bashkia?

Znj. Jorida Muho:Formulari I aplikimit ka si detyrim që familja të trajtohet me ndihmë ekonomike, dhe përzgjidhen vetëm familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike. Bashkia e ka nisur që para dy vjetësh pjesëmarrjen në projekte të tilla me impact social dhe do të vazhdoje edhe më tej.

Znj. Isaraj hedh në votë: P/Vendim "Për një ndryshim në VKB Nr. 100, datë 16.12.2022 "Për miratimin e PBA 2023-2025 dhe Buxhetit Vjetor 2023" me qëllim financimin e projekteve të investimeve".

Miratohet me 17 vota pro.

Kalohet te pika 5 e rendit të ditës:

Relaton në emër të bashkisë Z. Shpëtim Çoçka në lidhje me p/v "Për miratimin e Planit të Mbrojtjes Civile të bashkisë Gjirokastër për periudhën 2023-2027".

Sqarohet baza ligjore ku mbështetet ky plan, qëllimi I këtij plani dhe ku është mbështetur drejtoria për hartimin e këtij plani 4 vjeçar.Studimi I zonave me rrisht të lartë për jetën e qytetarëve dhe banesat, masat e zvogëlimit të rrishtit .

Z. Llogo: Ku mbështetet ky plan?

Z. Shpëtim Çoçka: Ky plan ka si qëllim organizimin e të gjitha strukturave në nivel lokal për mbrojtjen civile nga fatkeqësitë natyrore dhe njerëzore.

Znj. Muho: Qëllimi I këtij plani është edhe për t'i dhënë bashkisë mundësinë e aplokimit për grande konkurruese.

Miratohet me 15 vota pro dhe 2 abstenime pika 5 e rendit të ditës.

Kalohet te raporti Drejtorisë së Arsimit për masat e marra për fillimin e vitit të ri shkollor 2023-2024.

Raporton z. Ylli Muho dhe tregon prioritetet që kanë si drejtori dhe problematikat që kanë , si dhe masat që janë marrë për zgjidhjen e tyre.

Tre janë drejtimet e punës:

1. Higjena në shkolla.
2. Trajtimi ushqimor I fëmijëve në kopshte e çerdhe .
3. Ngrohja e Institucioneve arsimore.

Znj. Çabeli: Akeni ndojnë planifikim për bazën material për shkollën e muzikës?

Z.Brahimi: Si është gjendja e taracave të shkollave ?

Z. Muho: Kemi problem te shkolla “ Siri Shaplo” me lagështinë në katin e tretë. Një problem që besoj do t'i japim zgjidhje dhe më tej kemi edhe problem me lagështinë në shkollën : “ Petro Poga” dhe në shkollën “ Bilal Golemi”.

Z. Brahimi: Po në lidhje me 100 vjetorin e gjimnazit “ Asim Zeneli”, çfarë masash janë marrë? Aka ndonjë plan të mirfilltë në lidhje me këtë?

Znj. Muho: Është ngritur grupi I punës dhe po bashkëpunohet edhe me ZVA-në për aktivitetet.

Kalohet te 4 p/ vendimet që kanë të bëjnë me zgjedhjet në Njësitë Administrative.

P/Vendim “Për përcaktimin e datave dhe vendeve ku mbahen zgjedhjet”,hidhet në votë dhe miratohet me 17 vota pro që zgjedhjet të mbahen në datat 06.08-16.08.2023 . Vendi i mbajtjes të përcaktohet nga Administratorët e Njësive dhe të shpallen pranë çdo fshati datat dhe vendi.

P/Vendim “Për ngritjen e Komisionit për Monitorimin e Zgjedhjeve të Strukturave Komunitare në nivel bashkie ”.miratohet me 17 vota pro dhe përfaqësues i Bashkë Fitojmë të jetë z. Viron Peta.

P/Vendim “Për ngritjen e Komisionit për Monitorimin e Zgjedhjeve të Strukturave Komunitare në nivel fshati”, miratohet me 17 vota pro dhe emrat e përfaqësuesve të Këshillit Bashkiak sipas njësive të jenë:

NJ. Admin Lazarat: Petrit Brahimi ,Dashnor Aliko,

Nj Admin Odrie. Gentian Llogo, Fatjona Basha.

NJ. Admin Picar : Sokol Feruni, Mihare Lapa

NJ. Admin Lunxhëri : Lindita Leskaj, Fotis Kristidhi

NJ. Admin Cepo: Etleva Kondi , Shkëlqim Guçe

NJ. Admin Antigone : Armand Hilaj, Erion Kore

P/Vendim “ Për ngritjen e komisioneve të qendrave të votimit”, miratohet me 17 vota pro. Administratorët të përcaktojnë dy anëtarë komisioni .

Hidhet në votë dhe miratohet me 17 vota pro P/Vendim “ Për dhënien e titullit “ Qytetar Nderi” për z. Fabrizio Buci”.

Nga z. Drasa shprehet shqetësimi për punimet në lagjen “11 Janari” ku është vështirësuar trafiku. Sa të mbarojnë punimet të përdoret vetëm parkingu që punimet të ecin me ritëm më të shpejtë.

Mbyllet mbledhja nga Znj. Isaraj me porosinë që në mbledhjen e ardhshme të kërkohet informacion nga ekzekutivi për trafikun në qytet.

Sekretar

Etleva Yzo

